

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I

Shoqerise “ALB INFINITE ENGINEERS” SHPK

Sot në datën **30 Gusht 2025**, në Leshnje, Çorovodë-Skrapar, pranë selisë së shoqërisë “ALB INFINITE ENGINEERS” SHPK, në prani të ortakut të mëposhtëm:

Z. Artemon YLLI, atësia Luftim, amësia Ervehe, shtetas Shqiptar, lindur më 07.10.1976, në Çorovodë, Skrapar dhe banues në Tiranë, me adresë: ANASONI; Nd. 3; H. 1; KASHAR, YZBERISH, 1050; TIRANË, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i pasaportes Nr.BJ4937612, numer personal H61007083P, leshuar me datë 2.3.2016, nga MPB.

Në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, ka përpiluar si me poshtë Statutin dhe Aktin e Themelimit të shoqërisë “ALB INFINITE ENGINEERS” SHPK

Kreu I

Neni 1

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

- (1) Sot, me **30 Gusht 2025** (data e nënshkrimit të këtij Statuti), une, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “ALB INFINITE ENGINEERS” SHPK
- (2) Themeluesi i shoqërisë është (mbiemrat, emrat ose forma dhe emri ligjor i shoqërisë; adresat ose selia e numri dhe vendi i regjistrimit):

Me këtë Statut rregullohen këto çështje :

- emërtimi i shoqërisë,
- lloji i shoqërisë,
- adresa e selisë së saj,
- periudha e kohëzgjatjes,
- veprimtaria e shoqërisë,
- organet drejtuese,
- emrat dhe adresat e themeluesve,
- procedurat me të cilat mund të ndryshohen rregulloret dhe
- marrëdhëniet juridike ndërmjet themeluesve të shoqërisë, të drejtat e detyrimet e tyre, aksesin e të tretëve pranë kësaj zyre dhe menyrën e aplikimit të tyre për partneritet, llojin e partneritetit, rekrutimin apo punësimin e të asociuarve, menyrën

e bashkëpunimit me subjekte të tjerë privatë apo shtetërorë, kohëzgjatjen e veprimtarisë, kriteret e karrierës brenda shoqërisë nga të interesuarit etj.

Neni 2

VEPRIMTARIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- 1. Shoqëri Ndërtimi/Zbatimi, Aktivitete në fushën e studimit e projektimit, mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Zbatimit ne Ndertim dhe Konsulence, përmbledhur në:**
- 2.** Punime gjurmimi në tokë; Ndërtime civile dhe industriale; Rikonstruksione dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash; Rrugë autostrada mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale; Punime nëntokësore, ura e vepra arti; Diga dhe tunele hidroteknike; Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje; Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë; Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime; Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike; Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë; Punime të inxhinierisë së mjedisit; Punime për prishjen e ndërtimeve; Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre; Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues); Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese; Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut; Sinjalistika rrugore jondriçuese; Barriera dhe mbrojtje rrugore; Ndërtime parafabrikat beton/arme, struktura metalike dhe druri; Punime strukturore speciale; Shtresa dhe mbistruktura speciale; Punime mbi shina dhe traversa; Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit; Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni; Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.; Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore; Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij; Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane; Punime topogjeodezike; Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë; Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë. Mirëmbajtje objekteve. Plane kombëtare sektoriale; Plane të detajuara për zona të rëndësishme kombëtare; Plane sektoriale në nivel qarku; Plane sektoriale në nivel bashkie; Plane të detajuara vendore. Projektim arkitekturor. Projektim interiere; Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe. Objekte civile, industrial, turistike. Objekte me shkallë të lartë vështirësie; troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.

3. Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton arme, murature dhe metalike. Objekte civile e turistike prej druri. Projektim të instalimeve hidro termosanitare. Instalime termoteknike; kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme. Linjat e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale. Sistemeve komplekse të telekomunikacionit. Sisteme të furnizimit me gaz. Sistemeve kundra zjarrit. Sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa. Impiante ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.). Ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj. Rrjete të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj. Diga. Furnizim me ujë, kolektorë shkarkimi. Ujësjellës-kanalizime urbane, rurale. Vepra ujitje; kullimi; impiante vaditëse; diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha), damba, sifona, kaskada, kapërderdhës, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino. Vepra të trajtimit të ujit. Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi; shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse. Vepra naftësjellës; gazsjellës; vajsjellës etj. Vepra hidroteknike; kulla ekuilibri, porte; pontile. Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore. Rrugë. Autostrada. Aeroporte; heliporte; hidroporte. Hekurudha; degëzime hekurudhore.
4. Ura/viadukte, vepra arti dhe sisteme të tjera speciale. Tunele rrugore; hekurudhore. Rilevime inxhinierike dhe kadastrale. Sisteme GIS. Bazamente gjeodezike. Fotogrametri dhe hartografi. Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile; ekonomike. Studim/vlerësim gjeologoinxhinierik i truallit për objekte të mëdha H/Ç, porte aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha.
5. Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët. Centrale hidraulike, termike. Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, ere etj. Nënstacione elektrike; linja të tensionit. Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës; Sinjalistikë jondriçuese në rrugë, sheshe e parkime, autostrada, rrugë, hekurudha në degëzime, në aeroporte dhe heliporte. Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë. Studime të rrezikut sizmik. Vend-depozitime të mbetjeve të ngurta.
6. Studime e projekte të ndërtimit/Shërbime Konsulence Teknike, Ligjore e Financiare; Vlerësim Mjedisore dhe të Pasurive të paluajtshme; Restaurime në zbatim, projektim, mbikëqyrje e kolaudim; Arkeologji; Ekspertizë teknike dhe teknologjike; Mbrojtje nga Zjarri dhe Shpëtimi; Auditime energjetike.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të përcaktuar.

Neni 4

SELIA

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Zona Kadastrale Nr. 2423 Nr. i Pasurisë: 79/13-(1), Nd. 1; Fshati Leshnje, Njesia Administrative Leshnje, Skrapar, Çorovode.**
- (2) Numri i telefonit të shoqërisë është: **+355 69 260 28 82**
- (3) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: albinfinite@gmail.com

Kreu II

Neni 5

Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000 (njëqind mijë) lekë**. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tim të mëposhtem:
2. Ortaku themelues **Z. Artemon YLLI**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **100 000 (njëqind mijë) lekë** që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

8.1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12

Përgjithshmi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

KREU IV

Neni 13

Administrimi

Administrimi i shoqërisë do të kryhet nga administratori ose administratorët e Shoqërisë. Ata kanë të drejtat për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë, përveç atyre të drejtave që Ligji apo ky statut kalon Ortakëve të tjerë të Shoqërisë.

Administratori/Administratorët përfaqësojnë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët si dhe përpara organeve të administratës shtetërore apo ato gjyqësore.



Administratorët emërohen apo shkarkohen nga detyra e tyre me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Administratorët mund të jenë përgjegjës civilisht për dëmet që mund të shkaktojnë gjatë kryerjes së detyrës.

Administratorët përgjigjen në mënyrë të barabartë përpara Ortakëve për punën e tyre dhe u krijojnë atyre akses në çdo dokumentacion apo punë të Zyrës, kur kërkohet prej tyre.

Administrator i parë i shoqërisë **"ALB INFINITE ENGINEERS" SHPK**, do të jetë **Z. Artemon YLLI**, për një periudhë prej 5 vjetësh, me të drejtë riemërimi, duke filluar nga momenti i nënshkrimit të këtij Statuti dhe Akti Themelimi.

Administratori gëzon kompetenca të pakufizuara për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që Statuti ia njeh Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të theksin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 16

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

17.1 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave të përgjithshme tregtare të Shoqërisë;
- të modifikojë dhe ndryshojë Statutin e Shoqërisë;
- emerimin apo shkarkimin e administratorëve;

- të përcaktojë ekspertë kontabël të miratuar apo likuiduesit e Shoqërisë;
- mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- të përfaqësojë Shoqërinë në Gjykatë si dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- të riorganizojë dhe prishë Shoqërinë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 17

Kompetencat dhe kufizimet

18.1 Në Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Asamblesë mund të shqyrtohen dhe vendosen për çështje si më poshtë:

- Miratimi i mbylljes së veprimtarisë së Zyrës;
- Miratimi i shtimit/pakësimit të numrit të Ortakëve të Zyrës;
- Miratimi i fillimit të procedurave për falimentimin e veprimtarisë së Zyrës;
- Miratimin e shtimit të aktivitetit në fushat jashtë veprimtarive ligjore dhe rregjistrimet përkatëse sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

18.2. Mbledhja e jashtëzakonshme thirret vetëm nga Ortakët. Ajo ndjek, për aq sa përputhen, të njëjtat rregulla me Mbledhjen e Zakonshme.

Neni 18

Ortakët e rinj

19.1 Mbledhja e jashtëzakonshme e Ortakëve mund të lejojë mbi bazë unanimiteti pranimin e ortakëve të rinj.

19.2. Kriteret e pranimin të ortakëve të rinj përcaktohen rast pas rasti nga Ortakët Themelues, apo edhe Ortakët e bashkuar me vonë atyre. Për çdo rast vlerësohen cilësitë profesionale të kandidatit, fusha e veprimtarisë kryesore të tij, kontributi në mbarëvajtjen e punëve të deri atëherëshme të Zyrës, reputacioni publik i tij dhe të tjerë kriterë të vendosura nga Mbledhja e Ortakëve.

19.3. Në rast të shtimit të Ortakëve të rinj, rregullohen edhe marrëdhëniet ekonomike ndërmjet tyre, kuotat dhe kontributi, të cilat pasqyrohen menjëherë në statut

Kreu IV

Neni 19 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 20 Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t’ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t’i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka

KREU V

MBYLLJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË. LIKUJDIMI

Neni 21 Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 22

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 24

Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

ORTAKU THEMELUES
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ALB INFINITE ENGINEERS” SHPK

Z. Artemon YLLI

Artemon ylli. Ay